

**FORMULARI NUMËR 3**  
**KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR**

Emri:	Shehribane
Mbiemri:	Selimi - Muçaj

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni si vijon:

**I. Analizën tuaj:**

- Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?

Prokurori i Shtetit si një institucion i pavarur dhe i paanshëm për të luftuar krimin në Republikën e Kosovës dhe për të dhënë kontribut në sigurimin e sundimit të ligjit, funksionet e tij i ushtron në bazë të kushtetutës dhe ligjit, konsideroj se është në gjendje të mirë. Pas shumë sfidave nëpër të cilat ka kaluar, si plotësimi dhe ndryshimi i infrastrukturës ligjore, si dhe përmbytja e kapaciteteve dhe resurseve njerëzore që është arritur të përbushet deri diku, por jo në nivelin e kënaqshëm. Pasi që edhe sot ka mungesë të konsiderueshme të prokurorëve dhe stafit mbështetës në disa prokurori. Por përkushtimi për ngritjen e vazhdueshme profesionale, të llogaridhënieς dhe transparencës me ndihmën e vazhdueshme edhe të partnerëve ndërkombëtar është arritur që të ketë ngritje të qëndrueshme në të gjitha sferat. Çdo herë ka vend për t'u përmirësuar në të gjitha dimenzionet sidomos rritja e vazhdueshme e llogaridhënieς dhe integritetit, të cilat do të ndikojnë edhe në besimin e publikut, si dhe fuqizimin e sigurisë juridike.

- Si e vlerësoni gjendjen aktuale në prokurorinë për të cilën keni aplikuar?

Gjendja aktuale në Prokurorinë e Apelit, vlerësoj se është e mirë, por që ka vend për ndryshime dhe përmirësimë për të arritur nivelin e kënaqshëm që e dëshirojmë. Konsideroj se me ndryshimet e reja ligjore, konkretisht me hyrjen në fuqi të Kodit të Procedurës Penale në Shkurt të vitit 2023, roli i Prokurorisë së Apelit dhe ndikimi i saj në sistemin prokurorial në përgjithësi është fuqizuar dukshëm. Ashtu siç jeni në dijeni Prokuroria e Apelit edhe pse në numër jo të mjaftueshëm të prokurorëve dhe stafit mbështetës në krahasim me vëllimin e punëve dhe statistikat ekzistuese, gjithmonë për shkak të efikasitetit dhe profesionalizmit të lartë në çdo fund të vitit lëndët e mbeturë në punë janë zero. Nga kjo rezulton se përfundimi dhe zgjidhja e lëndëve të caktuara duhet të përfundoj brenda afateve ligjore, andaj nevojitet

angazhim maksimal që kjo të arrihet qoftë brenda orarit apo edhe jashtë orarit të punës, për shkak të respektimit të afateve ligjore.

### 3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?

Prokuroria e Apelit për rezultatin e arritur ballafaqohet edhe me sfida të shumta, siç janë numri jo i mjaftueshëm i prokurorëve dhe stafit mbështetës, si dhe hapësira dhe kushtet e punës në të cilën punojnë. Përveç prokurorëve, edhe personeli administrativ duhet që të ketë një ambient me kushte të përshtatshme të punës. Po ashtu, duhet që të rritet përgjegjësia dhe llogaridhënia e secilit për përgjegjësitë e tij, por që kjo duhet të mbështetet edhe me vazhdimin e ngritjes së kapaciteteve profesionale me njoħuri dhe praktika të vendeve të zhvilluara. Sfidë tjetër konsideroj që është zbatimi i suksesshëm i ndryshimeve ligjore.

### 4. A mendoni se strategjité aktuale të sistemit adresojnë nevojat e prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

Strategjité aktuale të sistemit edhe pse janë përbushur deri në një masë, vlerësoj se duhet të adresojnë qartë nevojat e Prokurorisë së Apelit, për t'i tejkular vështirësitë dhe sfidat të cilat paraqiten. Roli i Prokurorisë së Apelit edhe pse ka ndryshuar dukshëm me ndryshimet ligjore, por që deri më tanë nuk ka qenë në fokus zhvillimi i programeve adekuatë të trajnimit, qoftë me Akademinë e Drejtësisë apo mekanizma tjerë ndërkombëtar për të ngritur njoħuritë profesionale dhe zbatimin e suksesshëm të ndryshimeve ligjore.

## II. Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në prokurorinë që keni aplikuar?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

### 1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?

Vizioni im për Prokurorinë e Apelit është të përbushi mandatin ligjor me standarde më të larta profesionale dhe etike, duke vepruar me pavarësi dhe integritet të plotë. Me një vizion të qartë dhe një angazhim të përhershëm ndaj drejtësisë, do të jem e përkushtuar që prokuroria të jetë shembull i profesionalizmit dhe pavarësisë, duke kontribuar në një shoqëri ku të drejtat dhe interesat e qytetarëve mbrohen dhe promovohen në përpikmëri. Me plane konkrete kam për qëllim të transformoj Prokurorinë e Apelit në një institucion të besueshëm dhe efikas, ku transparenca dhe drejtësia janë parime themelore.

## 2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?

Puna ime si Kryeprokurore do të fokusohet në zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale, në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të lëndëve dhe në ndërtimin e një kulture institucionale të bazuar në integritet, llogaridhënie dhe respekt dhe besueshmëri të ndërsjelltë. Objektivat e mia kryesore përfshijnë:

- **Bashkëpunimi i ngushtë mes prokurorëve**

Bashkëpunimi i ngushtë dhe diskutimi i çështjeve të cilat kanë të bëjnë me lëndë të natyrës komplekse, dhe unifikimi i praktikave në vendosjen e këtyre lëndëve. Kjo çasje do të siguroj një analizë më të plotë dhe të drejtë të çështjeve komplekse dhe ndihmon në standardizimin e vendimmarrjeve. Për të arritur këtë synoj të krijoj takime grupore të rregullta dhe mbledhje të rregullta profesionale, ku prokurorët mund të ndajnë përvojat dhe të shprehin mendimet dhe këshillat e tyre profesionale lidhur me një çështje të caktuar.

- **Trajnimi dhe zhvillimi profesional i prokurorëve dhe stafit mbështetës**

Një prokurori e suksesshme kërkon një staf të përgatitur dhe të përditësuar me zhvillimet e fundit ligjore dhe praktikat më të mira. Një nga objektivat e mia kryesore është të promovojoj programe të rregullta trajnimi për të gjithë prokurorët dhe stafin e Prokurorisë së Apelit, me mbështetjen e Akademisë së Drejtësisë dhe partnerëve ndërkombëtar. Kjo do të përfshijë trajnime të ndryshme të cilat ndërlidhen direkt me punët e Prokurorisë së Apelit.

- **Bashkëpunimi ndërinstitucional**

Si objektivë e imja do të jetë bashkëpunimi me të gjitha prokuroritë veçanërisht takimet e rregullta me kryeprokurorët e prokurorive për të ngritur përmirësimin e mënyrës së zhvillimit të punëve të caktuara, sidomos të metat që janë evidentuar gjatë trajtimit të rasteve me ankesat e palëve të dëmtuara. Po ashtu, forcimi i besimit të publikut tek prokurori i shtetit në përgjithësi, e në veçanti në Prokurorinë e Apelit, sidomos adresimin e drejtë të pretendimeve ankimore të palëve të dëmtuara. Po ashtu, edhe ndërlidhja e sistemit të menaxhimit të lëndëve të Prokurorisë së Apelit me Gjykatën e Apelit.

## 3. Cilat janë sfidat që prisni gjatë përbushjes së këtyre objektivave?

Për t'i realizuar objektivat dhe vizionin tim kërkohet një angazhim jo vetëm i imi, por edhe i kolegëve të tjerë në prokurori. Menaximi dhe planifikimi i punës së stafit administrativ duke marrë parasysh që ka mungesë të stafit. Po ashtu, plotësimi i pozitave të nevojshme për prokurorë dhe staf mbështetës, bazuar në numrin e lëndëve që deri më tanë janë trajtuar dhe rritjen e numrit të këtyre lëndëve në

krahasim me vitet paraprake. Identifikimi i problemeve dhe tejkalimi i tyre, të cilat mund të paraqiten gjatë procesit të punës, si dhe ngritja dhe fuqizimi i rolit të Prokurorisë së Apelit.

#### 4. Si do t'i tejkalonit ato?

Me një bashkëpunim të mirëfilltë ndërcolegial do të arrijmë që synimet dhe vizionin e përcaktuar ta realizojmë me profesionalizëm të lartë, llogaridhënie dhe integritet. Secili do të raportoj për punën e kryer e në rast të vështirësimit të situatave të ndryshme që mund të paraqiten do të jap udhëzime dhe këshilla se si të tejkalohen ato, duke marrë parasysh gjithnjë mendimet që do të shprehen në takimet e rregullta me prokurorë dhe staf administrativ.

### **III. Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial**

Ju lutem renditni hapat konkretë që do t'i ndërmerrnit gjatë mandatit tuaj:

#### 1. Cili është modeli juaj në menaxhimin e stafit?

Duke marrë parasysh që suksesi i punës së prokurorëve varet edhe nga stafi mbështetës, prokurorëve do t'u jepen udhëzime të qarta se si duhet të përfshihet stafi në mbështetjen e tyre për zgjidhjen e lëndëve të caktuara. Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësive për secilin anëtar të stafit, për të siguruar që të gjithë të kenë objektiva të qarta. Takime javore ose mujore të rregullta me stafin për të diskutuar çështjet e përditshme, shqetësimet dhe sfidat që hasen gjatë punës. Organizimi i trajnimeve të rregullta në fusha kyçë, forcimi i llogaridhënieς dhe përgjegjësisë duke vendosur rregulla të qarta të llogaridhënieς për të gjithë anëtarët e stafit. Krijimi i një sistemi të brendshëm për raportimin e rregullt në përbushjen e objektivave.

#### 2. Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin?

Do të mundohem që të respektohen standarde për një shpërndarje të barabartë të punëve, duke marrë përbashkëtësi e tyre të punës, kërkeshat e prokurorëve, si dhe kërkeshat e ndryshme që mund të paraqiten nga vendet e ndryshme të punës. Do të kërkohen raporte javore, mujore dhe vjetore nga secili, me qëllim që asnjëri të mos ngarkohet më tepër me lëndë apo punë të tjera administrative se sa tjetri.

3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?

Rritja e llogaridhënieve dhe ngritja e vetëdijes së kulturës së raportimit të punëve dhe vlerësimi i kualitetit të tyre nga secili do të jetë nën mbikëqyrjen time. Përveç raportimeve të rregullta të punës do të kërkojen edhe raportime tjera të veçanta për punët tjera të cilat kanë ngecur. Do të punohet që të gjithë stafi, pavarësisht profilit të tyre të ndjekin trajnime të nevojshme për avancimin e shkathësive të tyre në vazhdimësi.

**IV. Hapat që do të ndërmerrni për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënieve së sistemit, prokurorisë dhe besimit të publikut?**

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Çfarë hapash do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj, duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?

Për të ngritur nivelin e besueshmërisë duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës, pa dyshim që do të jetë një sfidë në vete duke marrë parasysh që publiku dëshiron që çdo herë të jetë i informuar lidhur me rastet e ndryshme, e që ndonjëherë kjo edhe mund të dëmtojë integritetin, dinjitetin dhe sigurinë e të drejtës mbi privatësi të cilitdo qytetar. Edhe pse në Prokurorinë e Apelit nuk ka zëdhënës për media siç janë në prokuroritë e tjera, çdo herë kur të jetë e nevojshme përmes ZKPSH do të informohet publiku me informacionet që nuk do ta cenonin parimin e konfidencialitetit. Po ashtu për t'u ngritur besueshmëria në Prokurorinë e Apelit, do të mbështes ngritjen profesionale të prokurorëve dhe stafit, duke promovuar një vendimmarrje të bazuar në ligj dhe prova të cilat do të elaborohen në mënyrën e duhur.

2. Cilat janë planet tuaja për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?

Që nga fillimi i karrierës sime, puna cilësore ka qenë një ndër prioritetet e mia, çdo herë jam munduar që të ketë cilësi dhe jo sasi të punëve që i kam kryer. Për të siguruar një punë cilësore, nevojitet që si institucion të jemi shumë profesional, transparent, të pavarur, të paanshëm, efektiv në vendimmarrje. Andaj, çdo herë pas analizimit të hollësishëm të situatave të caktuara, do të jap udhëzime konkrete për procedura të qarta të veprimit, duke mos cenuar asnjëherë pavarësinë funksionale dhe profesionale të prokurorit.

3. Cilat janë planet tuaja për përmirësimin e llogaridhënisë së përgjithshme në Prokurorinë tuaj?

Edhe llogaridhënia dhe përmirësimi i saj do të jenë prioritet i punës time, duke ngritur vetëdijen se si prokurorët ashtu edhe stafi mbështetës do të vlerësohen në bazë të performancës së tyre. Të gjithë do të kenë përgjegjësi për veprimet e tyre duke pranuar të metat eventuale me qëllim të eliminimit të tyre, si dhe mbështetjes për t'i tejkaluar me sukses sfidat, por edhe për të mos i përsëritur gabimet eventuale. Edhe besueshmëria reciproke do të ndihmoj në përmirësimin e llogaridhënisë.

Deklaroj se përbajtjen e këtij konceptdokumenti e kam përgatitur vetë dhe jam në dijeni se i njëjti do të publikohet në uebportali.

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Datë: 08.11.2024